

**OVERVIEW ON THE FORM OF CONSTRUCTION OF
PHRASEOLOGICAL UNITS USED IN THE SPOKEN LANGUAGE IN
GJAKOVA**

**VËSHTRIM MBI FORMËN E NDËRTIMIT TË NJËSIVE
FRAZELOGJIKE TË PËRDORURA NË TË FOLMEN E GJAKOVËS**

Migena ARLLATI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Gjakova „Fehmi Agani”

*Corresponding author e-mail: marllati@gmail.com

Përmbledhje

Frazeologjia e përdorur në zonën e Gjakovës përmban një pasuri të madhe mjeteve shprehëse. Shumë nga njësitë frazeologjike shprehin nocione që nuk kanë emërtim tjetër, përmbajnë nuanca të veçanta kuptimore dhe emocionale të cilave nuk iu gjenden përgjegjëset sinonimike, pra njësitë njëfjalëshe. Në të folmen e Gjakovës, vërejmë pjesëmarrjen e mjeteve dhe tipave strukturorë në përputhje me variantin e gjuhës së folur në këtë zonë, e cila gjithsesi përbën një pasuri të konsiderueshme të fondit të frazeologjisë shqipe.

Si në mbarë frazeologjinë shqipe, nga pikëpamja e formës, si gjymtyrë bosht, në shumë prej njësive frazeologjike të përdorura në Gjakovë, dalin të pranishme fjalë të përdorimit të shpeshtë, sidomos foljet: *kam, jam, bëj, marr, bie* etj. dhe emrat që shënojnë pjesët e trupit të njeriut, si: *gojë, ballë, qafë, buzë, këmbë, sy, dhëmb, zemër, vesh* etj. Si rëndom në frazeologjinë shqipe, vërejmë se një formë shumë e zakonshme e ndërtimit është ajo me anë të krahasimit, formimet me hiperbolë, ndërtimet bazuar në përsëritjen e së njëjtës fjalë; grupin e ndërtuar : folje + emër foljor; formimet frazeologjike që kanë barasvlerësit delokutivë; Cungimi / shkurtimi është një tjetër dukuri ku njëra gjymtyrë nuk shprehet gjuhësisht, ndaj pjesa e mbetur merr përsipër të gjithë ngarkesën kuptimore të togut frazeologjik.

Fjalët kyçe: njësi frazeologjike, forma e ndërtimit, gjymtyrë bosht, variante gjuhësore, e folme dialektore.

Hyrje

Problematika e studimit të frazeologjisë së gjuhës është tejet e gjerë. Vetë frazeologjia është një thesar po aq i rëndësishëm sa edhe vetë fjalët. Shpeshherë, njësitë frazeologjike dëshmohen si formime më të hershme se njësitë leksikore, sinonimike me to. Ato konsiderohen si një prodhim historik ndaj janë zhvilluar e ndryshuar krahas leksikut dhe gjuhës në tërësi. Në gjuhësinë bashkëkohore shqipe, është ngulitur gjithnjë e më shumë koncepti se frazeologjia është tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve të cilat janë formuar historikisht dhe si të tilla janë kristalizuar si njësi të pandashme.¹⁹⁵

¹⁹⁵ M. Arllati, *Vështrim mbi frazeologjinë e të folmes së Gjakovës*, 2014, f. 44.

Ato për nga kuptimi kategorial janë të barasvlefshme me një fjalë të vetme. Shpesh, është paksa e vështirë të përcaktohet konkretisht zona e origjinës së lindjes fillestare të frazeonjesisë, pasi variante pafund të saj përdoren edhe nëpër treva të tjera, por ngjyrimet dialektore janë ato që e bëjnë shprehjen të jetë lehtë e dallueshme se nga cila zonë vjen, pra cilës zonë i përket. Këto shprehje janë bërë pjesë e makrosistemit, ndaj për të drejtën e autorësisë së tyre si zonë fillestare mund të pretendojnë njëkohësisht disa grupime banorësh, ose disa rajone a njësi administrative. Ose, mund të ndodhë që e njëjta shprehje, sikurse thashë pak më lart, të variantizohet dhe rreth “pushtetit” për të drejtën burimore të saj, të pretendojnë disa zona apo disa qytete njëherësh.¹⁹⁶

Në këtë punim do të ndalem në mënyrën e formimit të një sërë frazeologjizmesh të cilat kanë përdorim të zgjeruar në të folmen e Gjakovës, dhe si të tilla bartin edhe veçoritë e kësaj të folmeje zonale. Frazeologjitë janë njësi që kanë një kuptim të vetëm kategorial ndaj luajnë rolin e një pjese të vetme fjalie. Shpeshherë fjalët brenda një shprehjeje frazeologjike, janë të ngurosur në një trajtë të caktuar. Jani Thomai¹⁹⁷ thotë se nga ana e përmbajtjes ato kanë një kuptim të kushtëzuar ose të lidhur frazeologjikisht (e përgjithshme) kurse nga forma kanë një trajtë të caktuar e të pandryshueshme (e pjesshme).

Forma e ndërtimit

Ashtu si në leksikon e gjuhës, edhe tek ndryshimet e strukturës së jashtme e të brendshme të njësive frazeologjike, përfshirë këtu shtresat dhe tipet e ndryshme, pasqyrohet vetë zhvillimi i gjuhës. Ndryshimet formale të këtyre njësive të gjuhës janë të disallojshme, duke nisur nga ndryshime fonetike, leksiko-semantike, morfologjike, sintaksore, stilistike etj. Më poshtë do të trajtojmë disa nga problemet kryesore për kuptimin e tipareve, kufijve si dhe zhvillimin e frazeologjisë tek përdoruesit e saj në trevën e Gjakovës. Në të folmen e Gjakovës, vërejmë pjesëmarrjen e mjeteve dhe tipave strukturorë në përputhje me variantin e gjuhës së folur në këtë zonë, e cila gjithsesi përbën një pasuri të konsiderueshme të fondit të frazeologjisë shqipe.

Si rëndom në frazeologjinë shqipe, edhe në njësitë e frazeologjisë në të folmen e Gjakovës, vërejmë se një formë shumë e zakonshme është ajo me anë të krahasimit, ndërsa shumë të tjera formohen me anë të metaforës në leksikalizim. Në organizimin e togut frazeologjik një rol të veçantë luajnë lidhëzat krahasuese. Krahasimi ndonjëherë është i dukshëm pasi shoqërohet me lidhëzat krahasuese ‘si’, ‘sikur’. Për shembull: (duket) SIKUR DHÏJA NËR DHEN, (shkoi) SI CAPI TE KASAPI, (qëndron) SI MACA NËR SNI, (fjeti) SI KINGJI N’BARI, (u fry) SI BURE E SPECAVE, (shkojnë) SI UKI E DHÏA, (e kam) SI DRITËN E SYNIT, (është) SI ARA PA GRUN, (është) SI KALLAMOQ PA KOKRRA etj.

Po këtu renditen edhe ndërtimet me ndajfoljen ‘sa’ e cila më tepër zë vend në krahasimet që tregojnë madhësi, sasi, shkallë ose numër. Për shembull: (punoj) SA S’IA MERRTE MËNJA, (iu enjt këmba) SA T’DIHET, (hëngri) SA S’MAHET N’MËN, (kishte) SA T’HAN QENT, (le të ecë) SA T’I HAJN KOMT DHE etj. Këto shprehje herë-herë kanë në vetvete nuanca ironike. Ato shërbejnë si shprehje krahasuese të shfaqjeve të mëparshme por që në vetvete krijojnë njësi kuptimore me vlerën e fjalës. Jo rrallëherë kemi mospraninë e lidhëzës krahasuese e cila sidoqoftë vetëkuptohet.

Për shembull: U BO DHË, IU BO RRIQËN, BONU BURR’, E BON MIZËN BULL, I RA PLUM etj. Një rast tjetër paraqesin edhe njësitë frazeologjike që formohen me hiperbolë. Edhe në to ruhet ideja e krahasimit, pavarësisht se mund të jetë ose mund të mos jetë e pranishme lidhëza krahasuese: (sëmundja) E HONGRI T’GJALL’, IU BO ZEMRA MAL, E BON MIZËN LOP’ etj. Interesante na dalin edhe njësitë frazeologjike të cilat janë ndërtuar me togfjalësha, bazuar në përsëritjen e së njëjtës fjalë.

¹⁹⁶ M. Arllati, *Rrëfenjat urbane brenda shprehjeve frazeologjike*, 2016.

¹⁹⁷ J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, f. 19.

Këto njësi frazeologjike janë më afër fjalëve të përbëra nga shqiptimi por edhe nga ana kuptimore. Për shembull: KRE PËR KRE, PIK' PËR PIK', DIT' PËR DIT', KRAH M'KRAH, SY M'SY, ILAKE MAS ILAKE, VËN' MAS VËNI, HONGËR E PA HONGËR, VESH' E PA VESH', DATH' E DESH' etj. Variant të ngjashëm krijojnë edhe njësitë e formuara me togfjalështa të përbërë nga dy fjalë të së njëjtës pjesë ligjërë por që kanë një lidhje të caktuar kuptimore: ME QEN E ME STAN, LESH E LI, KESH E VESH, ASHT E LKUR, HUN E TURIJ, HI E PLUHUN, BE E RRFE etj.

Tek këto shprehje vërejmë se nga ana e lidhjeve të brendshme mes gjymtyrëve, ato kanë njësim kuptimor të fortë dhe kjo i bën të pazbërthyeshme. Në fakt këto njësi frazeologjike janë tip i thjeshtë për sa i përket anës së formës. Po ashtu, kemi praninë e shpeshtë të togfjalështave frazeologjikë që hyjnë në grupin e ndërtuar me: folje (kuptim i përgjithshëm) + emër foljor (i prejardhur nga një folje tjetër). Këtu hyn në përdorim të shtuar folja 'bëj' e cila sikur desemantizohet dhe fillon të luajë rolin e një foljeje gjysëmndihmëse. Për shembull: BON DURIM, BOJ PUSHIM, BONTE PËRPJEKJE, S'KISH DYSHIM, S'KA LIDHJE etj. Nuk mund të themi të njëjtën gjë kur vjen fjala për njësitë frazeologjike të cilat për gjymtyrë të dytë kanë një emër jofoljor ose ndonjë pjesë tjetër të ligjëratës.

Për shembull: BOJ FLÆJ' (fjalosem), BON BÉ (betohu), BON BALL' (përballoj), BON DOM (dëmtoj), BOJËM ZO (thirrëm), (po) BOJ MÆN (mendoj) etj. Por edhe: E MURR ANA, I DHA BES', E KA PISK (punën), SHET MÆN', BON BISHT, E MURR N'SY etj. Tepër interesante dalin formimet frazeologjike që kanë barazvlerësit delokutivë, pra fjalë të ndërtuara nga përngjitja e gjymtyrëve të një lokucioni: BZAJ - bëj zë, VREN - vë re, BON BE - betohet, ZON FILL - fillon, BON LLAF - llafos, I DHA FUN' - e përfundoi, BON GATI - gatit, përgatit etj. Vërejmë se në këto togfjalështa frazeologjikë çdo fjalë e ka humbur pavarësinë e saj ndaj duke u shkrirë nga ana e kuptimit me fjalët e tjera, na jep një kuptim të vetëm.

Jani Thomai, tek "Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe", fq. 40, shprehet se formimi i shprehjeve frazeologjike lidhet me veçoritë e fjalëve të veçanta, me veçoritë kuptimore, emocionale, të lidhjeve me fjalë të tjera etj. Kështu edhe në frazeologjizmat e Gjakovës, nga pikëpamja e formës, si gjymtyrë bosht, në shumë prej njësive frazeologjike, na dalin të pranishme fjalë të përdorimit të shpeshtë. Të tilla janë sidomos foljet: *kam, jam, bëj, marr, bie* etj. dhe emrat që shënojnë pjesët e trupit të njeriut, si: *gojë, ballë, qafë, buzë, këmbë, sy, dhëmb, zemër, vesh* etj.

Për sa i përket anës leksiko-gramatikore të fjalëve që ndërtojnë njësitë frazeologjike, na dalin lloje të shumta. Të larmishme janë edhe llojet sipas lidhjes sintaksore mes gjymtyrëve. Në frazeologjinë e gjuhës shqipe është karakteristike që ndërtimi i njësive frazeologjike krijohet po si ai i togfjalështave të lirë. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për njësitë frazeologjike në përdorim nga folësit në zonën e Gjakovës, si p.sh.: E MURR N'QAF', NUK MERR VESH, I KAN RA PËR THOJSH, BOJ NI SY QORR, IA NGUL SYT' etj. Tek disa njësi frazeologjike dallojmë ndërtimin me dy a më shumë emra, ku njëri luan rolin përcaktues për emrin tjetër. Këtu hyjnë në rol emra të rasave të ndryshme, të cilët në këto raste shoqërohen me ose pa parafjalën përkatëse: (punon) PËR BUKËN E GOJËS, (jeton) ME QYK' T'ZORIT, (u rrëzua) N'KOKËRR T'SHPINËS, (e do) SI DRITËN E SYVE, (rreh) UJ' N'HAVÁ etj.

Jo rrallë paraqiten rastet kur në njësitë frazeologjike zënë vend edhe marrëdhënie të tjera, si ajo kundrinore etj: E BONI MIZËN BULL, VNO GISHTIN KRES, I HASI SHARRA N'GOZHD, S'E NJEH I PARI T'DYTIN, I KA PLAS DELLI N'BALL, IU KA BO MÆNJA MADHE etj. Ato në përgjithësi shprehin marrëdhëniet mes subjektit dhe veprimit. Më pak hasen ndërtimet e marrëdhënieve përcaktore. Njësia frazeologjike këtu ka më shumë se dy gjymtyrë. Edhe në këtë rast vërejmë kombinimin me marrëdhënie të tjera: S'BON VO T'KUQE, BIRA E FUNIT E KAVALLIT, ME BÆRKIN THAT etj. Ato në përgjithësi shprehin marrëdhëniet mes sendit dhe cilësisë së tij.

Nuk mungojnë as ato njësi frazeologjike që shprehin marrëdhënie rrethanore mes veprimit dhe cilësisë ose rrethanës së veprimit: I SHKON TIMI DREJT, I BJEN PUNËS MAS, E KA BLE LIR, NUK I MERR VESH KRYT etj. Tek njësitë frazeologjike të anës së Gjakovës na dalin të pranishme struktura të tilla të fjalëve përbërëse të cilat i përkasin kategorive të ndryshme leksikore e gramatikore. Më të pasurit janë ndërtimet e skemës: folje+emër, folje+emër+emër, folje+ndajfolje.

Le ta konkretizojmë secilin prej këtyre rasteve me shembuj të veçantë:

Folje+emër: U RRE N'DRU, BONI DERT, ERDH N'VETI, KA FJÆL.

Folje+emër+emër: IA KA NXON RROTA BISHTIN, IA HUDHI TRUT N'ER, U PËRZI SHAPI ME SHEQERIN, S'IA HA QENI SHKOPIN, JU HINI SHERRI N'SHPI etj.

Folje+ndajfolje: E SHITI LIR, E PAGOI SHTREJT, E KAN TËRHEK ZVARR, BJERI MAS etj.

Më të zakonshme dhe shpesh të përdorura janë tipet e ndërtimit të skemës: emër+emër, emër +mbiemër, folje+emër+mbiemër, folje+folje, ndajfolje+ndajfolje.

Emër+emër: SI MISHI ME THONIN, SHPI MAS SHPIJE, GJAK E LAK, ME QEN E ME STAN, ME DOR N'ZEMËR etj.

Emër+mbiemër: (e priti) ME ZEMËR T'NGRINE, (vdiq) ME SY T'ÇELËN, ME SHPIRT T'VRAN etj.

Folje+emër+mbiemër: NUK SHKEL N'DRRAS T'KÆLBNE, S'BON VO T'KUQE, I KA MENT E MRAPSHTA etj.

Folje+folje: FOL E KESH, KESH E NGJESH, END E Ç'END etj.

Ndajfolje+ndajfolje: MAR E M'RAP, SOT PËR SOT, KEQ E PËR GAZEPI etj.

emër+mbiemër+emër: BIRA E MRAM E KAVALLIT, MÆNJA E MRAPSHT E DREQNIT etj.

numëror+emër: DY PAR MÆN, PËR NI PLLOM FTYR, S'I KA DY FIJE ÑER, DY FTYRSH NIRI.

numëror+numëror: PA NJË PA DY.

folje+numëror: JA BONI TET ME DY, S'I JEP PES PARE, ERDH VET E KATËRDHETA.

emër+numëror+emër: NI KERR MIJ PUN, NIRI ME DY FTYRA.

folje+emër+numëror: JU KA BO MÆNJA NJË.

Duhet vënë në dukje se skemat e mundshme të krijuara nga fjalët përbërëse të togfjalëshave frazeologjike, shtohen edhe më tej në sajë të përdorimit të parafjalëve, lidhëzave por edhe ndryshimit të rendit të fjalëve. Sidomos ndryshimi i rendit të fjalëve krijon laryshi brenda për brenda llojit. Ja një shembull konkret për këtë të fundit: THA ME GOJËN PLOT - THA ME PLOT GOJËN. Në përgjithësi, shprehjet frazeologjike kanë rend të ngulitur. Ndryshimi i rendit varet shumë edhe nga natyra e fjalisë, nga ngjyrimi shprehës e emocional etj. Karakteristike na del edhe ndërtimi i brendshëm bashkë me pjesore por në të folmen e Gjakovës, vendasit e kanë zëvendësuar këtë formë gjuhësore me trajtën e tyre dialektore. Kështu në vend që të thuhet: dalur, këtu përdoret: dal; në vend të: mbyllur, përdoret: mshel. Ndaj në shprehjet frazeologjike, ndërtimet me pjesore dalin disi më ndryshe. Ja disa shembuj: MET ME GOJ HAPT, FLEN ME SY ÇEL' etj.

Mes gjymtyrëve të njësive frazeologjike vihet re se **lidhja e brendshme sintaksore** është e detyrueshme. Për këtë lidhje Jani Thomai në monografinë e vet thotë se është e detyrueshme, e domosdoshme në gjuhën shqipe, ashtu si edhe për togfjalëshin e lirë¹⁹⁸. Lidhja sintaksore tek togfjalëshat e qëndrueshëm është përforcuar historikisht dhe ka arritur një shkallë të tillë, sa përbërësit kanë humbur pavarësinë krejtësisht ose pjesërisht.

¹⁹⁸ J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, f. 44.

Por meqë shprehja frazeologjike funksionon si njësi e vetme, ajo mund të krijojë lirshëm edhe lidhje me fjalë të tjera, sikurse të ketë edhe kufizime të ndryshme, ndaj në fjali dallojmë njësi frazeologjike me lidhje të detyrueshme dhe me lidhje të lirë. Së pari, **karakteri i detyrueshëm** i lidhjes në shumë prej shprehjeve frazeologjike, duket kur ato nuk mund të përdoren gjithmonë si në rastin fillestar. Për shembull: S'IA KOM MAJT QIRIN, është një shprehje që përdoret vetëm për çështje nderi.

Së dyti, disa njësi në përdorimin e tyre e kanë të domosdoshëm përshtatjen me fjalët e tjera në rasë, numër, kohë, vetë. Së treti, disa njësi paraqiten vetëm me kuptim mohues ose vetëm me kuptim pohues. Të kuptimit mohues janë: S'IA HAN MACA PËRRSHESHIN, S'LEN DY GUR BASHK, NUK E PRISH QEFIN, S'E SHEF DOT ME SY, S'BONI HÆJR KURR, NUK PRISH PUN etj. Të kuptimit pohues janë: U BO LOMSH, ÇELI SYT, IU BON TRUT AJRON, LOM U BO etj. Por e njëjta gjë ndodh edhe me njësi të tjera të cilat mund të marrin si kuptim pohues, ashtu edhe atë mohues: MERR VESH - S'MERR VESH, VUNI MÆN - S'VUNI MÆN, KA GISHT - S'KA GISHT etj.

Karakter i lirë i lidhjes në njësitë frazeologjike me lidhje të lirë, duket së pari në faktin se disa njësi mund të përdoren në çdo rast të ngjashëm me rastin fillestar. Për shembull: E NXURR NGA BALTA, përdoret gjithmonë kur duhet të tregohet ndihma që i është dhënë dikujt në vështirësi e sipër; KA DOR, përdoret gjithmonë kur duhet të tregohet se dikush ka marrë pjesë në organizimin ose planifikimin e një veprimi.

Së dyti, sepse disa njësi frazeologjike nuk përshtaten me fjalët e tjera në fjali sipas rasës, numrit, gjinisë, kohës, vetës. Për shembull: (unë) S'DU ME DIT, (ti) S'DON ME DIT, (ai/ajo) S'DON ME DIT, (ne) S'DOJM ME DIT, (ju) S'DONI ME DIT, (ata/ato) S'DOJN ME DIT. Së treti, karakteri i lirë duket edhe në faktin se disa njësi mund të kenë kuptim mohues dhe kuptim pohues, pra trajtë mohuese por edhe trajtë pohuese: MA PRISH QEFIN - S'MA PRISH QEFIN, M'SHKON NËR MÆN - S'M'SHKON NËR MÆN, MA MERR MÆNJA - S'MA MERR MÆNJA. Duhet vënë në dukje se në strukturën e këtyre njësive, pjesëzat mohuese “nuk”, “s”, nuk përfshihen në strukturën e së tërës sepse ato nuk janë pjesë të domosdoshme dhe nuk njësohen me pjesët e tjera.

Mes disa njësive frazeologjike gjejmë të pranishme disa elemente që në sistemin leksikor nuk kanë jetë si njësi më vete, por vetëm si **gjymtyrë përbërëse të togfjalëshave frazeologjikë**: VNO VESH', BON PALL', E HUPI KRYT. Të tilla njësi frazeologjike janë të ngurosurat ndaj qartësia e gjymtyrës së dytë përcaktohet nga afria me foljen. Këto gjymtyrë, nga ana e strukturës, janë të lidhura e s'duhet të ndahen nga elementet e tjera. Në rast të largimit ose veçimit nga folja, gjymtyra tjetër bëhet e paqartë ose e pakuptueshme.

Për sa i përket **ngurosjes së trajtës së gjymtyrëve** në njësitë frazeologjike, dallohen disa tipe:

- ✓ Fjala nuk ka trajtë tjetër të mundshme: BON FJÆL, BOJ DURIM, I BONI VORRIN.
- ✓ Fjala ka më tepër se një trajtë të mundshme por kjo vërehet në njësi të ndryshme frazeologjike: BONI QEF - I BONI QEFIN, TA MERR MÆNJA - TA MERR MÆNJEN.
- ✓ Fjala mund ta ndryshojë trajtën pa e prekur kuptimin frazeologjik: IU NXU FRYMA – IA NXONI FRYMËN.

Cungimi/shkurtimi është një tjetër dukuri e rëndësishme në ndërtimin e njësive frazeologjike. Kjo dukuri ka të bëjë me rastet kur njëra gjymtyrë nuk shprehet gjuhësisht, ndaj pjesa e mbetur merr përsipër të gjithë ngarkesën kuptimore të togut frazeologjik: S’IA KAP (truri), IA KA MLEDH’ (tetë me dy) etj. Nga të gjithë shembujt e mësipërm, shihet qartë se frazeologjia e përdorur në zonën e Gjakovës përmban një pasuri të madhe mjetesh shprehëse. Shumë nga këto njësi frazeologjike shprehin nocione që nuk kanë emërtim tjetër, përmbajnë nuanca të veçanta kuptimore dhe emocionale të cilave nuk iu gjenden përgjegjëset sinonimike, pra njësitë njëfjalëshe.

Referencat

- [1]. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Napoli, 2008.
- [2]. Arllati, Migena: *Vështrim mbi frazeologjinë e të folmes së Gjakovës*, Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Gjakovë, 2014
- [3]. Arllati, Migena: *Rrëfenjat urbane brenda shprehjeve frazeologjike*, Punim studimor, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare “Ditët e studimeve shqiptare”, Universiteti European i Tiranës, 2016.
- [4]. Thomai, Jani: *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1981.
- [5]. Thomai, Jani: *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
- [6]. *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botim i dytë i ripunuar, Toena, Tiranë, 2002.
- [7]. *Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.